

 Republika e Kosovës - Republika Kosova Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica Drejtoria për Punë të Pergjithshme Administrativë <small>Uprave za Ofice, Administrativne Postove</small>
<p>01</p> <p>016/01-181</p> <p>Data 10.10.2018</p> <p>Gjakovë - Djakovica - Gjakova</p>



MOMORANDUM MIRËKUPTIMI

Për implementimin e projektit: "**Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës**" finançuar nga Fondet e IPA-së, për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë-Shqipëri: **Ref: IPA/2017/394-641.**

Lidhur mes palëve:

- 1. Komuna e Gjakovës të cilën e perfaqëson Kryetari i komunës Z. Ardiq Gjini, në tekstin vijues theksohet ; Komuna**
- 2. Qendra Kosovare për Zhvillim të cilën e perfaqëson Drejtori Ekzekutiv Z.Avni Kasumaj në tekstin vijues; KDC**


Hyrje

Komuna e Gjakovës ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kosovare për Zhvillim (KDC) në shumë aktivitete, projekte, programe dhe përpilimin e dokumenteve strategjike. KDC është organizatë jo qeveritare e themeluar në 2001 me qëllim te nxitjes dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve në Kosovë dhe rajon.

Komuna e Gjakovës dhe KDC kanë punuar së bashku në përgatitjen e disa dokumenteve strategjike dhe planeve zhvillimore dhe gjatë procesit të bashkëpunimit janë përcaktuar prioritetet për zhvillimin e zonës dhe turizmi dhe një nga sektorët prioritari.

Nëpërmjet këtij Memorandum Mirëkuptimi, dy pjesëmarrësit pajtohen për të bashkuar forcat dhe të krijonë bashkëpunimin për të punuar së bashku në zhvillimin dhe zbatimin e projektit dhe pjesëmarrësit kanë shprehur gatimshmëri të bashkëpunojnë në kuader të zbatimit të projektit: "Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës."

Ky projekt korrespondon me marrëveshjen dy vjeqare ndërmjet Bashkimit Europian dhe ALCDF dhe KDC. Ky projekt parashikon rritje te punësueshmërisë dhe të ardhurave duke u bazuar në rritje të numrit të turistëve në Gjakovë dhe cilësinë e përvojës së tyre. Projekti do të stimulojë sektorin e bujqësisë; dhe do të fuqizojë qeverisjen lokale dhe shoqatat qeverisëse të OJQ gjë që e cila do të sigurojë qëndrueshmëri, përfshirjen gjinore, dhe do t'i hedhë bazat për klimë afariste të hapur dhe në përputhje me interest e rajonit. Nëpërmjet shfrytëzimit të vendimeve të informuara të të dhënavë, zinxhirin e vlerave, dhe



metodologjive të ndikimit kolektiv, do të zhvillojë dhe do të tregojë produkte eko-miqësore, kulturore, agroturistike dhe bujqësore, siç janë shtigjet dhe hartat, shtëpi banimi dhe fshatra me karakter tradicional dhe energji të vetë qëndrueshme dhe sisteme të menaxhimit të mbeturinave, itinerare ditore me informacionin e natyrës, kulturore dhe atraksione bujqësore; sinjalizime; shenja të përmirësuara të rrugëve duke komplementuar itineraret; me guida turistike të trajnuar.

Objektivi i përgjithshëm Projektit:

Promovimi i sektorin e turizmit të integruar dhe të qëndrueshëm në Komunën e Gjakovës nëpërmjet: rritjes së kapaciteteve dhe konkurrueshmërisë në sektorin e turizmit.

Qellimi final i projektit: **“Përmirsimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës”** është të promovojë rritjen dhe konkurrueshmërinë ne sektorin e turizmit të integruar dhe të qëndrueshëm ne rajonin ndërkufitar nga promovimi i ekonomisë së trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike të saj, respektivisht rregullimin dhe shenjimin e shtegut nga shpella e kusarit

Neni 1: Objektivat e palëve

Palët janë dakorduar që të bashkëpunojnë me qëllim që të sigurojnë implementimin e projektit në fjalë duke u fokusuar në objektivat dhe duke perfshirë gjitha palët siç kërkohet në project.

Neni 2. Përgjegjësitë e palëve

- Vlera e projektit: **“Përmirsimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës”** është : **219,762.00** eurove.
- KDC obligohet që të bashkëpunoj me komunën, respektivisht zyrtarët komunal të caktuar per implementimin e projektit.
- KDC do të raportoj në baza mujore lidhur me aktivitetet e realizuara, si dhe për kostot e projektit
- KDC do te ofroj raporte financiare dhe semi- anuale dhe anuale per komunën.
- Komuna do të ofroj bashkëpunim per realizimin e projektit si dhe siguroj ko-financim në shumën prej 20% të vlerës totale të projektit ose **43,952.4** eurove.
- Komuna merr përgjegjësinë që vlerën financiare të cekur më lartë ta transferoj në log. Rrjedhëse të KDC-së. Procredit Bank , nr. i llog. 1140061294000113.
- Komuna obligohet që brenda vitit 2018 të pagaguaj pjesrisht bashkëfinancimin në vlerë prej **13,000.00** eurove, ndërsa pjesen e mbetur në vlerën prej **30,952.4** eurove do ta paguaj më se largu deri me 30.6.2019.
- Komuna do të angazhoj zyrtarët e vetë që të marrin pjesë në aktivitetet e projektit
- Komuna do siguroj gjitha të dhënat e kërkua të lejet (licencat) dhe dokumentet tjera të kërkua për realizimin e projektit.
- Pas perfundimit të projektit komuna obligohet që ta marr ne pronësi projektin, ta monitoroj dhe të siguroj një qëndrueshmëri të projektit.



Neni 3. Periudha e implementimit

Projekti do të realizohet deri ne mars, 2020.

Neni 4. Përputhshmërija me ligjin

Ky memorandum i mirëkuptimit do të realizohet në perputhshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Neni 5. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjet eventuale permes negocimeve direkte ne mes veti, bazuar në këtë memorandum të mirëkuptimit, në të kundërtën gjykata përkatëse do jetë kompetente për zgjidjen e kontesteve eventuale.

Neni 6. Kopjet

Ky memorandum është i perpiluar në 4 kopje identike dhe palët do të marrin nga dy kopje identike.

Neni 7. Hyrja në fuqi

Ky memorandum hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të palëve të përfshira.

PËR: KOMUNËN E GJAKOVËS

PËR: KDC

Z: ARDIAN GJINI

KRYETARI I KOMUNËS

DATA: 10.10.2018




Z. AVNI XASUMAJ

KDC TOKEZKUTIV

DATA: 10.10.2018





Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet

Qendrës Kosovare për Zhvillim

&

Komunës së Gjakovës

Për implementimin e projektit:

“Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës”

Ky memorandum Mirëkuptimi (i përshkruar më poshtë) konfirmon se partnerët e lartëpërmendur, Komuna e Gjakovës dhe Qendra Kosovare për Zhvillim (e përshkruar më poshtë si KDC) në bashkëpunim me Partnerin Liderë Shoqata e Zhvillimit të kapacitetit shqiptarë (ALCDF) dhe Makedonska Fondacioni za Pretpriatija (MRFP)

Dëshirojnë të bashkëpunojnë në projektin **“Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës”** i cili do të promovojë sektorin e turizmit të integruar dhe të qëndrueshëm në Komunën e Gjakovës nëpërmjet: rritjes së kapaciteteve dhe konkurrueshmërisë në sektorin e turizmit.

Qellimi final i projektit **“Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës”** është të promovojë rritjen dhe konkurrueshmërinë ne sektorin e turizmit të integruar dhe të qëndrueshëm ne rajonin ndërkufitar nga promovimi i ekonomisë së trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike të saj. Ky projekt është i financuar nga Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri me nr. Ref: IPA/ 2017/394-641.

1. Hyrje

Komuna e Gjakovës ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kosovare për Zhvillim (KDC) në shumë aktivitete, projekte, programe dhe përpilimin e dokumenteve strategjike. KDC është organizatë jo qeveritare e themeluar në 2001 me qëllim te nxitjes dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve në Kosovë dhe rajon.

Komuna e Gjakovës dhe KDC kanë punuar së bashku në përgatitjen e disa dokumenteve strategjike dhe planeve zhvillimore dhe gjatë procesit të bashkëpunimit janë përcaktuar prioritetet për zhvillimin e zonës dhe turizmi dhe një nga sektorët prioritar.

Nëpërmjet këtij Memorandum Mirëkuptimi, dy pjesëmarrësit pajtohen për të bashkuar forcat dhe të krijonë bashkëpunimin për të punuar së bashku në zhvillimin dhe zbatimin e projektit dhe pjesëmarrësit kanë shprehur gatishmëri të bashkëpunojnë në kuader të zbatimit të projektit: “**Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës.**”

Ky projekt korrespondon me marrëveshjen dy vjeqare ndërmjet Bashkimit European dhe ALCDF dhe KDC. Ky projekt parashikon rritje te punësueshmërisë dhe të ardhurave duke u bazuar në rritje të numrit të turistëve në Gjakovë dhe cilësinë e përvojës së tyre. Projekti do të stimulojë sektorin e bujqësisë; dhe do të fuqizojë qeverisjen lokale dhe shoqatat qeverisëse të OJQ gjë që e cila do të sigurojë qëndrueshmëri, përfshirjen gjinore, dhe do t'i hedhë bazat për klimë afariste të hapur dhe në përputhje me interest e rajonit. Nëpërmjet shfrytëzimit të vendimeve të informuara të të dhënavë, zinxhirin e vlerave, dhe metodologjive të ndikimit kolektiv, do të zhvillojë dhe do të tregojë produkte eko-miqësore, kulturore, agroturistike dhe bujqësore, siç janë shtigjet dhe hartat, shtëpi banimi dhe fshatra me karakter tradicional dhe energji të vetë qëndrueshme dhe sisteme të menaxhimit të mbeturinave, itinerare ditore me informacionin e natyrës, kulturore dhe atraksione bujqësore; sinjalizime; shenja të përmirësuara të rrugëve duke komplementuar itineraret; me guida turistike të trajnuar.

2. Obligimet e bashkëpunimit

Njësia lokale qeverisëse/Komuna është përgjegjëse për menaxhimin e duhur dhe shfrytëzimin e resureve natyrore, tradicionale dhe historike për promovimin dhe zhvillimin e turizmit. **KDC**, brenda fushëveprimit te procesve të lartëpërmendura, nëpërmjet projektit “**Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës**” do të sigurojë ndihmë dhe përkrahje për zbatimin e strategjive & proceseve përmes lehtësimit të tyre per të gjithë akterët. Përmes këtij Memorandum Mirëkuptimi pjesëmarrësit shprehin gatishmëri të bashkëpunojnë brenda kornizës për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në komunën e Gjakovës.

3. Objektivat e përgjithshme të bashkëpunimit

Objektiva e përgjithshme e këtij bashkëpunimi është të përkrahë dhe t'i sigurojë drejtim zbatimit të projektit të lartë përmendor: “**Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës**” me hapat në vazhdim:

Qëllimi i përgjithshëm është i dyfishtë, *synon rritjen e punësueshmërisë, veqanërisht e të rinjve dhe grave; dhe te rrisë të ardhurat e familjeve Gjakovare të përfshira në zingjirin furnizues të turizmit.*

Projekti parashikon të hedh bazat e këtij momenti duke fuqizuar elementet kritike brenda sektorit, për të shërbyer si katalizator i krijimit të vendeve të punës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. KDC dhe partnerët e tij kanë zgjedhur strategjikisht të adresojnë problemet e zhvillimit të produktit turistik.

4. Marrëveshje për rezultatet e parapara

Në bazë të objektivave të përgjithshme të cekura më lart, pjesëmarrësit përkushtohen në bashkëpunim për arritjen e objektivave specifike të mëposhtme:

Rezultati 1: Të zhvillojë dhe të promovojë produkte të reja turistike në zonat alpine me përfshirje direkte të fermerëve lokalë.

- Infrasktrukturë e përmirësuar për zhvillimin e turizmit në kasollet e bariut
- Rritje e kapaciteteve të popullatës rurale për shërbime turistike
- Promovimi i vlerave unike të kasolles së bariut si udhëheqës të bujqësisë dhe zhvillimit të turizmit.

Rezultati 2: Të iu rritë njojuritë fermerëve lokalë për të siguruar shërbime më të mira dhe më cilësore për të përfituar direkt nga turizmi

- Ngritje e vetëdijes dhe vizionit të përbashkët e furnizuesve të agroturizmit nëpërmjet krijimit të një platforme të mësimit të turizmit dhe vizitave studimore duke theksuar modelet e praktikave më të mira;
- Rritje e njojurive dhe përmirësim i shërbimeve nga ofruesit e zingjirit furnizues të bujqësisë nëpërmjet trajnimeve formale të aftësive dhe shërbimeve intensive te zhvillimit të kapaciteteve.

5. Përkushtimi i KDC

KDC është përgjegjëse për implementimin e projektit : Përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës. Në pajtim me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet BE dhe KDC, KDC do të sigurojë që objektivat e projektit të përbushen në mënyrën më të mirë. KDC do të iu siguroje të dhëna dhe informacione të rregullta të gjithë akterëve të përfshirë në projekt dhe efektivisht do të shpërndajë informacion për aktivitetet e ndërmarra, dhe progresin e arritur brenda projektit të lartë përmendur.

Në bashkëpunim me akterët kryesorë, mund të përcaktohen detyra specifike në kornizën e projektit për të përkrahur akterët kryesorë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në komunën e Gjakovës.

Përderisa KDC është përgjegjëse për implementimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të projektit, projekti ka themeluar një “ekip menaxhues” të përbërë nga partnerët, ALCDF; MRFP; dhe përfituesit-partnerë, komuna e Gjakovës.

Ekipi Menaxhues (MT) i cili drejtohet nga drejtori i KDC / Koordinatori i Projektit do të takohen në baza tremujore gjatë gjithë jetës së projektit. Partnerët e projektit kanë gjetur sinergji rrith të njejtë mit se turizimi rural do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës së Gjakovës.

6. Përkushtimi i Komunës

Komuna e Gjakovës pajtohet të bashkëpunojë si partnere për arritjen e objektivave dhe kontributit do te jetë si në vijim”

- Komuna e Gjakovës do të marrë pjesë aktivisht në gjithë procesin e implementimit të projektit dhe pritet të caktojë Specialistin Turistik të tij si personin kontaktues për projektin;
- Komuna e Gjakovës konfirmon se projekti i propozuar është në pajtim me standartet e veprimeve aktuale dhe të planifikuara në Komunën e Gjakovës si dhe në strategjinë territoriale.
- Komuna e Gjakovës do të vëjë në dizpozicion të gjithë personelin përgjegjës gjatë gjithë periudhës implementuese të projektit nga stafi administrues dhe teknik punonjës të projektit. Ky personel duhet të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e planifikuara përritjen e kapaciteteve dhe do të marrë përsipër detyrat pasi të finalizohet projekti.
- Komuna e Gjakovës duhet të sigurojë ndërhyrjen dhe bugjetet e nevojshme për aktivitetet e modelimit, siç janë infrasktruktura në fshatrat turistike, shtëpitë e banimit, shënjimin dhe nënshkrimin e shtigjeve për ecje etj.
- Komuna e Gjakovës do të sigurojë informacion për aktet nënligjore, regulacione të ndryshme, vendime të qeverisë, ndryshime në politika (duke përfshirë mbrojtje mjedisore / pëlqim) e cila mund të ketë ndikim në rezultatet e projektit.
- Komuna e Gjakovës pritet të përkrahë realizimin e projektit ne kapacitetin e tij të plete si institucion publik i cili synon të sigurojë shërbime më të mira dhe qytetarëve të vet më shumë mundësi përvende pune nëpërmjet sektorit te integruar të turizmit rural.

7. Kohëzgjatja

Ky MiM ndërmjet partnerëve do të jetë kohëzgjatja e projektit të lartë përmendur, me pikënisje nga: Tetor 2018- Mars 2020.

8. Monitorimi dhe vlerësimi

Për të përkrahur dhe përvende përdorim implementimin e mbikëqyrjen e projektit, të gjithë partnerët do të takohen në baza tremujore përtë rishikuar progresin dhe përtë siguruar mbikëqyrje sipas nevojës. Partnerët do të përbëhen nga përfaqësuesit e nominuar siç janë të detajuara në dokumentin e projektit për implementimin e këtij projekti. KDC do të ketë rolin ndihmës në organizimin e këtyre takimeve përtë reflektuar dhe vlerësuar punën e përfunduar në mënyrë që të implementohet projekti.

KDC parashikon të realizojë shërbimet e tij me standarda të larta të profesionalizmit, kompetencë etike, dhe integritet. Në përfundim të periudhës së MiM, do të shkruhet një rishikim i MiM dhe raport përfundimtar i projektit. KDC do të inicojë dhe ndërhyjë rishikimin e procesit (vlerësimin), dhe partnerët parashihet të marrin pjesë në procesin e rishikimit.

9. Përfundimi

I. Të gjithë pjesëmarrësit do të kenë të drejtën të përfundojnë këtë MiM duke i japur njoftim me shkrim pales tjetër në rast të:

- Dallimeve ideologjike të papajtueshme ndërmjet pjesëmarrësve;
- Shpërdorim të resurseve financiare;
- Mungesë bashkëpunimi nga njëra apo pala tjetër;
- Paftësi në përbushjen e aktiviteteve sipas marrëveshjes së aktivitetit të dakorduar
- KDC dhe EU duke ndaluar veprimtaritë në Shqipëri.

Përfundimi i këtij MiM nuk do të ndikojë ndonjë të drejte apo detyrime të përllogaritura të ndonjë pale.

10. Procedura e Daljes

Të gjithë pjesëmarrësit do të përkushtohen që t'ia komunikojnë zyrtarisht tjetrit nëse duan ta përfundojnë MiM apo nëse nuk duan të vazhdojnë marrëdhënien në përfundim të këtij MiM.

11. Vlefshmëria e këtij MiM

Ky MiM do të jetë i vlefshëm në ditën kur do të nënshkruhet nga të gjithë Pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit përcaktojnë marrëveshjen e tyre të plotë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit nga nënshkrimi juaj i mëposhtëm:

Për: Komunën e Gjakovës	
Z: Arđian Gjini	
Kryetar i Komunës	Drejtore Ekzekutiv
Data: 10.10.2018	Data: 10.10.2018